



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT  
DREJTORIA E PROCESIMIT TË BIZNESIT

14665  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 23.10.2017

### UDHËZIM

Nr. 17 datë 23.10.20

### PËR

### “ PROCESIN E EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE NË SISTEMIN INFORMATIK FINANCIAR TË QEVERISË ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, (i ndryshuar), Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” (i ndryshuar), si dhe në Marrëveshjen Kuadër nr. 716/1 datë 20.01.2015 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për Ofrimin e Shërbimeve Financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë”,

### U D H Ë Z O J

#### I. TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e ekzekutimit të pagesave elektronike në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

## II. PROCEDURA E PUNËS

Faturat për shpenzim të regjistruara në SIFQ, pasi janë vleftësuar dhe miratuar nga të gjitha nivelet e aprovimit do të kalojnë në procesin e ekzekutimit të pagesës duke ndjekur hapat si më poshtë vijon:

1. **Kontrolli i fondeve me planin e thesarit**
2. **Limiti Ditor i Pagesave**
3. **Ekzekutimi i pagesave**

### 1. **Kontrolli i fondeve me planin e thesarit**

- a- Për të përmbushur kërkesën për kontrollin e fondeve në planin e thesarit të disponueshëm në momentin e kryerjes së pagesave të faturave të shpenzimeve të regjistruara dhe të miratuara më parë në SIFQ, do të ekzekutohen dy programe, përkatësisht për lëshimin e fondeve dhe vendosjen e bllokimit ndaj faturave të papaguara.
- b- Të gjitha faturat e miratuara dhe të vleftësuar me sukses do të vendosen në bllokimin e planit të thesarit, i cili nuk lëshohet manualisht nga përdoruesit. Ky bllokim hiqet automatikisht nga ekzekutimi i programit të rezervimit të fondeve. Të gjitha faturat që do të kalojnë me sukses kontrollin e fondeve në plan thesari, do t'u lëshohet bllokimi për planin e thesarit dhe do të jenë gati për pagesë.
- c- Procesi i ekzekutimit të programit të rezervimit të fondeve do të realizohet dhe mirëmbahet nga përdorues të autorizuar në strukturën përgjegjëse për Thesarin.
- d- Grafiku i ekzekutimit të programit të rezervimit të fondeve në plan thesari bëhet në varësi të numrit të faturave të aprovuara në SIFQ deri në fund të çdo dite pune.
- e- Për të llogaritur kohëzgjatjen e programit të rezervimit të fondeve, çdo ditë merret informacion nga struktura përgjegjëse për IT-në mbi numrin e faturave të aprovuara në sistem, duke marrë parasysh kohën që kërkon programi për të bërë kontrollin e një fature.. Ky program duhet të ekzekutohet pas orarit zyrtar të punës kur nuk kryhet rregjistrim i faturave për shpenzim në SIFQ. Në raste të veçanta, ky program mund të ekzekutohet edhe gjatë orarit të punës, pasi të ketë përfunduar sesi i fundit i pagesave, nën monitorimin e strukturave përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.
- f- Ç' rezervimi i fondeve në lidhje me planin e thesarit për faturat e miratuara dhe të papaguara ose pas anulimit të pagesës, nëse ka të tilla, bëhet nëpërmjet ekzekutimit të një programi të dytë i cili rivendos bllokimin ndaj faturave që kanë mbetur të papaguara në fund të ditës.

- g- Proçesi i ekzekutimit të programit të çrezervimit të fondeve në plan thesari do të realizohet dhe mirëmbahet nga përdorues të autorizuar në strukturën përgjegjëse për Thesarin..
- h- Për të llogaritur kohëzgjatjen e programit të çrezervimit të fondeve në plan thesari, përdoret informacion mbi ditarët e obligimit të krijuar nga procesi i rezervimit të fondeve në plan thesari, duke marrë parasysh kohën që kërkon programi për të procesuar secilin prej ditarëve të obligimit të krijuar.
- i- Programi i rezervimit dhe ai i çrezervimit të fondeve në plan thesari duhet të ekzekutohen në kohë të ndryshme nga njeri tjetri.

## **2- Limiti Ditor i Pagesave**

- a- Të gjitha faturat që regjistrohen në modulën e të pagueshmeve të cilat janë të vlefshme dhe miratuara në të gjitha nivelet vendosen në bllokimin e limitit ditor.
- b- Bllokimi i Pagesës nuk mund të hiqet manualisht, por vetëm nëpërmjet ekzekutimit të kërkesës së limitit ditor.
- c- Kërkesa e ekzekutimit të limitit ditor do të procesojë vetëm ato fatura të cilat e kanë të lëshuar bllokimin e planit të thesarit (sqsuar sipas pikës 1 më sipër).
- d- Vendosja e Limiteve Ditore të pagesës do të konsistojë në hapat e mëposhtëm që janë të varur nga njëri tjetri:
  - Bllokimi i Pagesës
  - Rregjistrimi i Limiteve Ditorë të Pagesës dhe Rregullave të Prioriteteve (në rastet e përcaktuara në udhëzimin përkatës)
  - Programi i Lëshimit të Bllokimit të Pagesës
  - Programi i Lëshimit të Rivendosjes së Bllokimit të Pagesës
- e- Limiti Ditor do të vendoset nga persona të autorizuar në strukturën përgjegjëse për Thesarin bazuar në balancën e miratuar të gjendjes së cash-it.
- f- Limiti Ditor vendoset në tre sesione gjatë ditës në oraret e përcaktuara në marrëveshjen kuadër nr. 716/1 datë 20.01.2015 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për Ofrimin e Shërbimeve Financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë”.

- g- Programi për Rivendosjen e Bllokimit të Pagesës do të ekzekutohet në fund të çdo dite pune, i cili ekzekutuhet manualisht ose automatikisht.

### **3- Ekzekutimi i Pagesave**

- a- Të gjitha faturat të cilat i kanë të lëshuara bllokimet e planit të thesarit dhe limitit ditor do të përfshihen në grupimin e pagesave të krijuar në SIFQ nga struktura përgjegjëse për Thesarin dhe struktura përgjegjëse për menaxhimin e Borxhit Publik, nëpërmjet ekzekutimit të kërkesës së krijimit të pagesave.
- b- Pas konfirmimit të pagesave në SIFQ sipas pikës a) më sipër, struktura përgjegjëse për krijimin e pagesave elektronike pranë strukturës përgjegjëse për Thesarin ekzekuton në SIFQ kërkesën e krijimit të grupimit të pagesave.
- c- Pagesat e krijuara sipas pikave a) dhe b) do t'i dorëzohen Bankës së Shqipërisë për ekzekutimin e saj konform rregullave të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër nr. 716/1 datë 20.01.2015 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- d- Banka e Shqipërisë dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë konfirmimin e pagesave të ekzekutuara dhe të pagesave të refuzuara në sistemin bankar konform rregullave të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër nr. 716/1 datë 20.01.2015 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

Bashkëlidhur këtij udhëzimi gjendet Aneksi 1 “Gjurma e auditit për procesin e ekzekutimit të pagesave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.”


Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**

**Aneksi 1**

*Gjurma e auditit për procesin e ekzekutimit të pagesave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.*



## Simbolet dhe Shkurtime



Fillimi ose perfundimi i procesit



Aktiviteti

Oraret e vendosjes se limit ditor jane te percaktuara ne marrev.me BSH

Komente mbi aktivitetin apo dokumentin



SIFQ –Sistemi Informatik Financiar I Qeverise

DTH – Deget e Thesarit

IB –Institucionet buxhetore me akses ne SIFQ

DPBP – Drejtoria e Pergjithshme e Borxhit Publik

DPTH-Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit

Sektori M.Funks.-Sektori I Mirembajtjes  
Funksionele

DIT-Drejtoria e Teknologjise se Informacionit  
Sektori DL-Sektori I Drejtimit te Likuiditetit

Sektori RF-Sektori I Raportimit Financiar

Sektori TSA-Sektori I Llogarise se Unifikuar te  
Thesarit